

Njoftim për marrje ambjente me qera

Drejtoria Rajonale Tatimore Fier kërkon të marrë me qera ambjente për zyra për akomodimin e punonjësve të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Rajoni Jugor, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. KRITERE TË PËRGJITHSHME

- Objekti që do të merret me qera duhet të jetë i përshtatshëm për ambjente zyrash pa pasur nevojë për ndërhyrje të mëtejshme, për punime rikonstruksioni apo përshtatje nga ana e qeramarrësit. Hapësirat duhet të jenë të shfrytëzuara mirë dhe funksionale.
- Objekti që do të merret me qera duhet të jetë jo me larg se 200 m nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me sipërfaqe jo më pak se 250 m², jo më shumë se 300 m² dhe me mundësi zgjerimi në të ardhmen.
- Objekti që do të merret me qera duhet t'i vihet në dispozicion qeramarrësit deri me datën 31.12.2021, me opsion shtyrje edhe për vitet e tjera nëse do të jetë e nevojshme.
- Objekti duhet të ketë ambjente higjeno-sanitare dhe kushte të përshtatshme pune.

2. DOKUMENTACIONI I KERKUAR

- Objekti të jetë me dokumenta të rregullta ligjore, të mos ketë barrë hipotekore, sekuestro ose çdo dokument tjetër me të cilin vërtetohet posedimi i ndërtimit.
- Vërtetim nga Furnizuesi i Sherbimit Universal dhe Ujësjetës Kanazime Fier Sh.a, që subjekti nuk ka detyrime të palikujduara për objektin.
- Objekti duhet të ketë furnizim të rregullt me ujë të pijshëm dhe energji elektrike me matës të dedikuar.
- Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, se nuk ka proces penal, civil apo administrativ ndaj administratorit / pronarit të këtij objekti.
- Dokument identifikimi i pronarit të objektit (pasaportë ose kartë identiteti).
- Dokumentat e kërkuara me siper të jenë kopje origjinale ose fotokopje të noterizuara.
- Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj kundrejt lëshimit të faturës tatimore. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve tatimore do të kryhet nga DRT Fier, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat e tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.

Shënim: Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë në formën e tij ligjore (i njesuar me origjinalin) dhe i lëshuar brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ofertës.

Ofertat, me kriteret si më sipër, duhet të paraqiten deri në datën **16.07.2021, ora 14.00, pranë zyrës së protokollit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, në adresën: Lagjia “Apollonia”, Rruga “Brig. 11-te Sulmuese, Fier.**